VENDIM
Nr. 183, datë 29.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SOLE 24 DOOEL SHKUP–DEGA NË SHQIPËRI" DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1432/1 prot., datë 26.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri', degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri", degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1432 prot., datë 19.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria "Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri", degë e shoqërisë së huaj, ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat: "a", "b" dhe "c", si dhe pikën 2.5.
- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

Pika 1.2, dokumentacioni juridik dhe administrativ

germa "b": shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore për shoqërinë, si edhe për administratorin e saj, ndaj në vijim do t'i kërkohet t'i përcjellë ato.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Sole 24 Dooel Shkup–Dega në Shqipëri", degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti